

Procesverbal

Nga Mbledhja IV (e katërt) e rregullt për vitin 2026 e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë: 29.04.2026

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Rishqyrtimi i vendimit 01Nr. 060/01-2909/26, për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimi e punës në teren për zgjedhjen e këshillave lokale,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026 – 2030,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar janar – mars për vitin 2026,
5. Propozim për bartjen e mjeteve vetanake të pa shpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026,
6. Eventuale.

Resul Fetahu: Të nderuar të pranishëm, mirë se erdhët në seancën e katërt të rregullt për vitin 2026! Besoj se materialin e keni pranuar të gjithë me kohë. Në rendin e ditës i kemi pesë pika, si dhe pikën eventuale. Nëse dikush dëshiron ta marrë fjalën lidhur me rendin e ditës, urdhëroni!

Usmen Baldzi: I nderuar Kryetar i Komunës, Kryesues i Kuvendit, anëtarë të Kuvendit, përfaqësues të mediave, përfaqësues të OSBE-së dhe të gjithë të pranishmit, Dua vetëm ta informoj Kuvendin me faktin se po përsëritet e njëjta situatë si në mbledhjen e kaluar të Komitetit për Komunitete, ku jam përpjekur të ndikoj në ndryshimin e rendit të ditës. Shtrohet pyetja se si mund të jesh përgjegjës dhe të votosh për rendin e ditës, kur, pavarësisht se jemi në opozitë, nuk përfshihemi në hartimin e tij, dhe as nuk pyetemi për pikat që propozohen. Në vend të kësaj, na ofrohet një propozim i gatshëm sipas parimit “merre ose lëre”. Çfarë ka të keqe nëse, qoftë në Komitetin për Komunitete apo në atë të Financave, apo edhe para vetë seancës së Kuvendit, gjatë përcaktimit të rendit të ditës, propozuesi të konsultohet edhe me anëtarët e tjerë — gjithsej jemi 21 — dhe të pyesë nëse ka ndonjë propozim, problem apo çështje që duhet të përfshihet? A ka tema nga terreni që shqetësojnë qytetarët e komunës së Dragashit dhe që duhet të jenë pjesë e rendit të ditës? Kjo është pika e parë. E dyta... Ne më të moshuarit e dimë se ky institucion, kjo Kuvend i Komunës së Dragashit, falë qytetarëve dhe njerëzve nga Gora dhe Opoja, ka pasur dinjitet. Këtu janë mbajtur mbledhje të cilat mund t’i kenë zili jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë. Këtu kanë qenë të ulur njerëz me përvojë dhe njohuri serioze. Nuk ka qenë e mjaftueshme të kesh vetëm letërnjoftim për të qenë anëtar i Kuvendit të Komunës së Dragashit — kjo thjesht

nuk ka mjaftuar. Megjithatë, sot gjërat nuk po shkojnë në drejtim të mirë. A është e mundur që në Gorë, sa i përket komunitetit joshumicë, gjendja të jetë aq e mirë sa të mos ketë nevojë të hapen çështje të rëndësishme? Dhe ne e dimë që nuk është kështu. Gora po zbrazet, popullsia po plaket, problemet janë të pranishme kudo. Dhe në këto rrethana, si mund ta mbështes një rend dite të tillë? Prandaj, i nderuar kryesues, në këtë mënyrë unë nuk mund dhe nuk do të votoj për këtë rend dite.

Resul Fetahu: Faleminderit! A do dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim rendin e ditës. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Me 18 vota për, 1 kundër dhe zero abstenim, miratohet rendi i ditës. Vazhdojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 18 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e dytë: Rishqyrtimi i vendimit 01Nr. 060/01-2909/26, për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimi e punës në teren për zgjedhjen e këshillave lokale. A dëshiron dikush me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Pasi që sot e kemi kërkesën për rishqyrtim të vendimit, këtu i kemi gjashtë antarë, të gjithë të gjinisë mashkullore. Atëherë ju si pushtet duhet ta zgjidhni dhe ta mundësoni kuotën gjinore. Unë e kam një propozim, e kam bërë edhe dje në komitet, por prapë do ta bëj edhe sot. Propozimi im është që z.Uzair Hamza të jetë në këtë listë, sepse pa Uzairin nuk bën asnjë komision. Kërkoj nga grupi parlamentar i PDK-së që mos ta largojnë dhe e ka mbështetjen time sepse është një lojtar shumë i mirë dhe di si mi ndrrue dresat edhe për kuotën gjinore bën ai, sepse është i kapshëm. Domethënë, propozimi im është që gjithsesi ai të jetë pjesë e këtij komisioni. Ju faleminderit.

Bexhet Xheladini: Përshëndetje për të gjithë. Lidhur me vendimin që e lexoi kryesuesi, ministria na e ka kthyer si të paligjshëm. Arsyeja është se nuk e kemi zbatuar kuotën gjinore. Prandaj unë propozoj që në vend të numrit një të propozohet Merybe Ramadani dhe në vend të numrit pesë të propozohet Elmedina Neziri. Atëherë në qoftë se duhet prej asamblesë, le të jetë Xhyllferije Bahtijari.

Resul Fetahu: Atëherë po ju lexojë edhe njëherë nenin 6 paragrafi 8 i Ligjit për Barazi Gjinore:

“Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji.

Artan Loshaj: Zoti kryesues, pasi sot po i referoheni ligjit ku keni qenë seancën e kaluar, kur i kemi propozuar kandidatët, pasi këtu po thotë se komisioni do t'i referojë përfaqësimit gjinor dhe etnik, atëherë nga komuniteti jo shumicë të dy kandidatët janë të gjinisë mashkullore, atëherë që e propozova Uzairin të jetë nga minoriteti, atëherë edhe nga komuniteti jo-shumicë le të bëhet 50-50.

Resul Fetahu: Atëherë kërkojë edhe një propozim nga subjekti JGP.

Danis Hodza: Përshëndetje për të gjithë. Nga subjekti i JGP-së e propozojmë znj. Ventaza Esati. Ju faleminderit!

Resul Fetahu: Atëherë, po i lexojë emërat e komisionit që janë me ndryshime: 1. Xhyllferije Bahtijari – LDK, 2. Granit Rifaj – PDK, 3. Uran Halimi – VV, 4. Ventaza Esati – JGP, 5. Merybe Ramadani – anëtarë i ekzekutivit, 6. Uzair Hamza – anëtarë i ekzekutivit.

Atëherë e hedhim në votim rendin e ditës. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Me 11 vota për, 1 kundër dhe zero abstenim, miratohet rendi i ditës. Vazhdojmë me pikën e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026 – 2030. A do dikush me e marrë fjalën?

Fari Kolloni: Përshëndetje për të gjithë, nuk po du me ju marrë shumë kohë pasi që besoj që materialin e keni pas dhe keni pasur mundësin me e shqyrtue, veç ju kisha lutur që edhe ju të jepni kontributin tuaj, nëse keni ndonjë propozim, në mënyrë që ta kemi sa më të kompletuar dokumentin, sepse Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun është një dokument i rëndësishëm që do të na shërbejë në funksion të rritjes së transparencës së Komunës. Kushdo që ka ndonjë propozim apo vërejtje konkrete, i mirëpresim. Ju faleminderit!

Artan Loshaj: Para se ta nis diskutimin, kolegë, të përgëzoj për këtë pauzë që na keni bërë. Tamam jeni bërë sikur Adem Hoxha në parlament, kur e pritnim atje në parlament, edhe ne ju kemi pritur ju dhe partinë tuaj. Bravo ju qoftë! Këtë vetëm pushteti i LDK-së e bën. Sa për strategjia si plan është shumë e mirë, me siguri edhe ChatGPT-ja më mirë nuk do të mund ta kishte bërë. Bravo ju qoftë! Është shumë perfekte, besoj që do të implementohet, sepse shumica e dokumenteve tuaja mbasin vetëm në letër. Vetëm disa vërejtje të vogla kam. Edhe dje kam diskutuar në Komitet me kryetarin dhe anëtarët e komitetit. Anëtari i komisionit, zoti Fari, këtu thotë se pjesëmarrja e qytetarëve në takimet publike ka qenë 30%. A mos është ndonjë gabim, a mos është 0.03 për qind, sepse 30% e 25 mijë banorëve i bie rreth 7-8 mijë banorë që të jenë në takime publike. Me siguri keni mbajtur ndonjë takim ku unë s'kam qenë, ndoshta në ndonjë

stadium. Sipas 30% të 28 mijë banorëve, i bie rreth 7 mijë banorë. Në dy takimet e fundit, dëgjimet publike që kemi mbajtur, njëri ka qenë në qershor ku kam qenë prezent dhe tjetri në fund të vitit. I kemi edhe fotot. Kanë qenë katër apo pesë qytetarë të Dragashit, ka qenë administrata komunale, punëtorë të QKMF-së, disa OJQ dhe nxënës të shkollës së mesme. I kemi edhe fotot këtu. Herën tjetër kur ta bëni, uleni pak, sepse nuk është 30%. Te pika 3.5, komunikimi i brendshëm, e dimë shumë mirë se çfarë raportesh ka brenda ekzekutivit. Nuk dua të flas për hir të disa personave që janë kontribues dhe nuk dua të flas para qytetarëve këtu, prandaj do të hesht. Përndryshe, e dimë shumë mirë se çfarë raportesh ka mes ekzekutivit dhe drejtorëve. Shkojmë te faqja 11, ku thuhet se komuna e Dragashit ka një nivel të kënaqshëm të komunikimit mes organeve ekzekutive dhe legjislativit, shumë mirë. Në të gjitha mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit merr pjesë kryetari. Edhe dje i kam thënë që e respektoj për vullnetin, sepse është kryetari më prezent, edhe pse jemi kundërshtarë politikë. Por thuhet se së bashku me drejtorët komunal u përgjigjet pyetjeve të këshilltarëve në lidhje me ecurinë e punëve. Këtë e dini shumë mirë, ku nga tetë drejtorë vetëm dy apo tre janë prezent. E dini shumë mirë që SMART drejtori na ofendon për mosdije, pra nuk ka komunikim të mirë mes legjislativit dhe ekzekutivit. Kur bëhet fjalë për planin dhe punën e tyre, pra për planin dhe raportin e punës, nuk raportojnë. Disa janë nga Prizreni, disa kanë ardhur këtë vit, disa vitin tjetër. Këtë nuk e dimë. Disa të SDU-së nuk guxon t'i prekë kryetari sepse janë të paprekshëm. Sidomos ai drejtori im, kryetari e ka lënë anash dhe sot nuk është prezent.

Pra, ky plan në përgjithësi është shumë i mirë, por herën tjetër kur ta bëni, uleni pak këto shifra, sepse jemi në komunën e Dragashit, një komunë shumë e vogël. Ju faleminderit.

Granit Rifaj: Përsëritet për të gjithë. Deshta të ndërlihem shumë shkurt, sepse nuk dua të bëj politik, pasi që nuk e kam ndërmend të bëhem kandidat për deputet. Po unë e kisha lutur kryetarin apo ekzekutivin që kjo të del edhe njëherë në diskutim publik me publikun, këtu kanë thënë kolegët paraprak se këtu kanë qenë vetëm zyrtarët komunal, i keni publikuar vetë fotografit. Kjo strategji duhet të diskutohet me qytetarët. Nuk po ia lë fajin juve, ndoshta e keni bërë ftesën dhe nuk kanë ardhur. Por është më mirë që më tepër të shpërndahet nëpër media, që me pas një debat qysh duhet. Ju faleminderit.

Usmen Baldzi: Strategjia e hartuar dhe e paraqitur për shqyrtim ka kuptim. Është përgatitur mirë dhe shihet se është bërë një përpjekje serioze. Po ashtu, vërehet se propozuesi ka punuar me

përkushtim në hartimin e saj — nuk ia di emrin dhe kërkoj ndjesë për këtë. Megjithatë, do të doja ta rikujtoj për diçka që e kam theksuar edhe më herët në Kuvend. Në njërën nga mbledhjet e mëparshme kam kërkuar që të përmirësohet faqja zyrtare e komunës. Jo vetëm të përmirësohet, por të sigurohet që të gjitha informacionet të jenë në dispozicion në kohë, në tri gjuhë — në çdo moment, sapo ato të dorëzohen nga organet komunale, kryetari dhe të gjithë pjesëmarrësit në përgatitje. Herën e kaluar kam theksuar se kjo nuk ishte rasti, se nuk kishte transparencë të mjaftueshme, gjë që na vendos në një situatë ku nuk i përmbushim standardet bazë të hapjes ndaj qytetarëve. Prandaj mendoj se, nëse në planin e veprimit të kësaj strategjie parashihet përmirësim konkret i faqes së komunës dhe një nivel më i lartë transparence, atëherë kjo strategji meriton mbështetje. Meqenëse nuk më është dhënë fjala, më vjen vërtet keq, por ju lutem — kjo mënyrë e punës nuk ka kuptim, sepse cenon parimet demokratike. Nuk do të kthehem tani prapa, por kjo nuk është hera e parë që ndodh. Krijohet përshtypja se disa personave nuk u lejohet të flasin. Shoh se ekziston njëfarë urrejtjeje, ndoshta edhe e natyrave të tjera, edhe pse nuk ka nevojë për këtë. Në çdo rast, më vjen keq për këtë qasje. Unë vetëm desha të propozoj që të ndihmoj kryesuesin, në mënyrë që kjo vendim të mos na kthehet përsëri. Një vendim tashmë na është kthyer, tani edhe një tjetër — dhe kjo nuk është e mirë as për komunën e Dragashit, e as për këtë Kuvend. Unë dua vetëm të mirën e këtij Kuvendi. Në vetë vendimin shkruhet qartë — më lejoni ta lexoj: Komisioni nga pika 1 e këtij neni përbëhet nga 7 anëtarë. Më tej thuhet se prej tyre 4 janë anëtarë të Kuvendit, ndërsa 2 nga pushteti ekzekutiv. Megjithatë, anëtarët e propozuar nuk e përmbushin këtë kusht — njëri është nga pushteti ekzekutiv, ndërsa tjetri nuk është. Prandaj kam menduar që, në vend të Uzeir Hamzës, të propozohet drejtoresha e inspektoratit, në mënyrë që përbërja të jetë në përputhje me vendimin. Në këtë mënyrë, ky vendim do të ishte i rregullt dhe besoj se nuk do të na kthehej. Kështu si është tani, kam frikë se do të na kthehet përsëri. Këtë e propozoj me qëllimin më të mirë

Samidin Xheladini: Përshëndetje për të gjithë. Strategjia për komunikim dhe marrëdhënie me publikun 2026-2030. Unë do të lexoj që ta di edhe opinionin nëpërmjet mediave. Do të përmend disa pika. Është një strategji shumë e qartë. Qëllimi i hartimit të kësaj strategjie për informim dhe komunikim është që ta mbështesë traditën e tashme të krijuar të komunikimeve të strukturave në mënyrë që mekanizmat komunikues të jenë efikas, të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm dhe si të tillë të mbështesin në përmbushjen e misionit të komunës dhe forcimin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale përmes komunikimit proaktiv dhe profesional me mediat dhe krijimi i formave efektive për ndërveprim dhe dialog me qytetarët.

Fari Kolloni: Atëherë Artan, po të përgjigjem, sepse ndoshta dje jemi keqkuptuar. Sa i përket asaj përqindjes të cilën po e përmend, nuk është fjala për 30% në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë, është fjala për 30% numrit të anketuarve. Domethënë, kjo është shumë e thjeshtë dhe e qartë. Besoj se është e kuptueshme. Sa i përket pyetjes së Granitit, konsultimi publik, ky draft dokumenti ka qenë në konsultim publik. ka qenë edhe në mënyrë elektronike në webfaqen e komunës prej datës 26 mars deri më 10 prill. Gjithashtu është mbajtur edhe takimi fizik këtu. Kanë marrë pjesë ata të cilit kanë marrë. Kemi dy objektiva kryesorë të strategjisë. Objektivi i dytë është pra rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Pra, këtë strategji të cilën jemi duke e bërë, është për me bo një punë më të mirë dhe me rrit numrin e pjesëmarrësve në konsultimet publike. Besoj që këto procedura kanë qenë ligjërisht krejt në rregull. Ju faleminderit.

Artan Loshaj: I nderuar koleg, z.Fari, më herët keni thënë, edhe dje keni thënë që Helvetasi e ka bërë këtë dokument. Pse Helvetasi a nuk gabon? Vet i kemi fotot ku kam qenë prezent edhe unë. Në qershor dhe ja ku janë 30% e punëtorëve të komunës të cilët i ka anketuar Helvetasi. Është e mundur. Foto në Facebook, në faqen zyrtare të komunës Dragash. E keni 4 qershor ku unë kam qenë këtu si anëtar i komitetit, e kemi mbajtur takim dhe ja ku janë fotot. Kanë mundur të jenë 12 apo 13 veta punëtor të komunës, unë, Radiosharri kan qenë tre-katër qytetarë, barazia gjinore, kryetari, nuk ka pas qytetarë të rëndomtë këtu. Nga djetori i keni sjellur punëtorët e spitalit. Bëhuni të singertë dhe thoni: i marrim punëtorët e komunës, të spitalit dhe të shkollave, ata janë të detyruar të vijnë këtu dhe t'ju bëjnë tifo. Ky është realiteti. Ja ku janë fotot. Të gjithë qytetarët e komunës së Dragashit kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjime publike. Është një gjë që ata kanë të drejtë të vijnë. Është e singertë që 30 për qind e të anketuarve janë punëtorë. Kush është Helvetas? Ata janë njerëz si ne dhe mund të gabojnë. Në këtë 30 për qind janë të intervistuar punëtorët e komunës dhe të spitalit, dhe u krye muhabeti.

Granit Rifaj: Nuk po dua ta zgjas shumë as ta politizoj. Nuk po e akuzon kërkush pushtetin, sepse ju nuk mund ti sjellni këtu qytetarët, me dhunë. Kanë qenë njoftimet, në qoftë se ka mundësi që ta propozojmë me mbajt edhe një herë, unë, pasi që unë vet jam asambleist dhe nuk e kam ditë që është mbajt. Është mirë që me mbajt edhe një herë, në qoftë se keni mundësi, në qoftë se jo, ju mund ta vazhdoni, i keni votat.

Fari Kolloni: Vetëm një propozim konkret i nderuar kryesues. Propozoj që në faqen nëntë tek perceptimet e qytetarëve, si fusnotë me e integruë linkun që të dërgon te anketa e Helvetasit dhe

Demos dhe aty pastaj kush është i interesuar mundet me e pa metodologjinë se si e kanë ndjekur ata. Ju faleminderit.

Samidin Xheladini: Në qoftë se më lejohet, pasi që popullata nuk e di qëllimin, sepse këtu po shkruan qartë strategjia për komunikim dhe marrëdhënie me publikun. Ky është një dokument që hap rrugë dhe i rrit mundësitë mundësitë tek qytetarët me marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme në komunikim me komunën dhe shtetin. Unë e pashë këtu një shkresë dhe e kam lexuar dhe më la për shtypje. Të gjitha këto janë me vend dhe të qelluara, por transparencja për pjesëmarrje të qytetarëve. Ne të gjithë po kërkojmë transparencë dhe jemi për atë. Sidomos opozita e ka kërkuar transparencën më tepër se pozita. Gjatë vitit 2022-2025, komuna e Dragashit ka shënuar përmirësim të dukshëm sa i përket nivelit të transparencës dhe komunikimit me publikun. Si rezultat i përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së përgjithshme, për herë të katërt radhazi, është rritur dhe është në mesin e përfituesve të grantit të performancës. Domethënë, katër herë e kemi fituar. Vet komuna e Dragashit është llogaritur në mesin e dhjetë komunave me transparencë me pikë 82 përqind. Vetëm këta dështa që t'jau përkujtoj. Ju faleminderit.

Resul Fetahu: Ju faleminderit! A do dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 11 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar Janar – Mars për vitin 2026; A do dikush tjetër me marrë fjalën?

Qamil Kolloni: Përshëndetje për të gjithë, sot po raportojmë për tremujorin e parë për vitin 2026 për shpenzimet e realizuara dhe të hyrat për vitin 2026. Në bazë të nenit 45 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi me numër 03/048, kryetari i komunës është i obliguar që të përgatisë dhe të dorëzojë Kuvendit Komunal raportin periodik i cili mbulon vitin fiskal deri në fund të tremujorit të vitit që sapo ka përfunduar. Pas shqyrtimit nga kuvendi komunal, raporti financiar tremujor duhet të publikohet edhe në faqen zyrtare të Komunës. E lexova këtë me të vetmin qëllim për arsye se u diskutua për rregulloren dhe transparencën. Komuna e Dragashit dhe qeverisja aktuale e Bexhet Xheladinit, në vitin 2021 nuk ka gjetur as rreguloren për integritet dhe nuk ka gjetur as webfaqen e komunës të plotësuar me të dhëna për transparencë. Ju e dini që në vitin 2022, duke filluar nga Brendi si zyrtar për informim deri tek faqja webfaqja është pasuruar deri në atë masë dhe një prej kushteve për përfitimin e grantit është transparencja publike. Dhe këtë transparencë është plotësuar dhe ngritet vit për vit, në qoftë se e keni parë, poentimin e grantit të performancës. Kjo rregullore të cilën zyrtari e paraqiti pak më herët, është vetëm një vakum i vogël

ligjor i cili duhet ta plotësojë krejt këtë punë madhore të institucioneve të cilat janë bërë në qeverisjen e Bexhet Xhelaldinit. Prandaj, shpeshherë unë ndjejë kënaqësi kur njerëzit flasin për profesionet e veta. Por nuk ndihem mirë kur hyn në profesionet e të tjerëve. Unë kurr nuk hyj në mjekësi për arsye se nuk e njohë atë fushë.

Mirëpo, shumë mirë në raport thuhet se 30% nga numri, në qofte se ka qenë në dëgjim publik, 7 antarë, 30% e tyre është 9 anëtarë dhe kemi pasur rritje për 2 anëtarë, shumë e thjeshtë është. Por kur duhen të politizohen gjërat dhe kur nuk e njeh profesionin, raporti është i detajuar, shumë i përshkruar dhe faktik. Të gjitha këto transaksione, veprime, të cilat janë të parapara për shpenzime, janë në sistemin informativ të menaxhimit të financave të Kosovës. Gjithashtu, ky raport pas kësaj mbledhje bëhet publik dhe në çdo kohë ju të cilat keni qasje në internet mund ta shihni në webfaqen e Komunës. Prandaj, këtu kemi të bëjmë me gjëra shumë të thjeshta, konkrete dhe transparente, pa kurrfarë problemi dhe pa kurrfarë kompleksi. Në qoftë se diku jë këshillimi i duket fyerje, mua më vjen shumë keq. Buxheti i komunës për vitin 2026 i miratuar në asamblenë komunale është edhe pjesë e pasqyrave tabelare të paraqitura në ligjin e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2026. Ky buxhet përmban në pikat e shkurtra: paga dhe mëditje 7 milion e 25 mijë euro; mallra dhe shërbime 1 milion e 513 mijë euro; shërbime komunale 400 mijë euro; subvencione dhe transfere 400 mijë euro; shpenzime për investime kapitale 3 milion e 705 mijë euro; rezervat janë 200 mijë euro. Total buxheti ka qenë 13 milion... Fondi i Donatorëve për vitin paraprak ka qenë 3.847 euro, Helvetasi, Qeveria Zvicerane 6.105 euro, Ambasada Sllovene 2.999 euro, grantet të tjera të jashtme, Ambasada Bullgare 1 euro. Realisht buxheti përmban 13 milion e 267.836 euro. Nga këto, për mos me marrë shumë kohë për secilën kategori, se sa është shpenzuar deri më tashë po shkojmë te shpenzimet buxhetore të cilat janë krijuar gjatë këtij viti.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë: 263,3497.80 euro, Shpenzimet Komunale janë: 62,431 euro, Subvencionet dhe Transferet janë: 407 euro, Shpenzimet për Investimet Kapitale janë: 356,178.89 euro. Pra nga gjitha këto shpenzime, mund të ju them se kemi pasur edhe të hyra vetanake. Siç ju kemi raportuar edhe në seancat e kaluara për shkak të sistemit jo funksional të tatimit në pronë gjatë këtij tremujori kemi një rënie të inkasimit të të hyrave vetanake. Gjithashtu qeveria ka bërë një njoftim. Se sistemi informativ dhe afati i ankesave është zgjatur edhe për një muaj. Për këtë arsye do të mundohemi me ekipin që këto ankesa ti rregullojmë në momentin kur të funksionalizohet i tërë sistemi i tatimit në pronë, besoj që Komuna jonë në fund të vitit përsëri

të dalë me të hyra vetanake plus siç ishte edhe në vitin 2025, pasi që i kemi pasur të njëjtat vështirësi dhe kështu do ta kalojmë planin e parashikimeve buxhetore.

Granit Rifaj: Dua të ndërlidhëm që kjo praktik të përfundoj këtu. Me dalë këtu drejtori dhe gjithmonë me bo demagogji, ai ka të drejtë të dalë vetëm si këshilltar i kryetarit, edhe atë në qoftë se ja jep të drejtën kryetari. Për pikat e rendit të ditës, me na tregue neve se çfarë profesioni kemi ne, ato të gjitha i dinë qytetarët dhe për atë na kanë sjellë këtu qytetari. Për me bo politik në këtë kuvend jemi ne, asambleistët. Neve qytetarët na kanë sjellë këtu, ti je i emëruar. Të lutem, mos ofendo më njerëz, nuk je adekuat ti me na tregue se çfarë profesione kemi, me na mbajtë ligjërat këtu, se çfarë bëjmë e çfarë z'bëjmë, po të respektojmë shkaku i moshës, por ti disa pi nxjerr nga vetja me dhunë. Gjithmonë ke dalë këtu dhe ke bërë politika përçarëse. Vetëm ngjallë debate, pa arsye. Askush nuk të ofendoi, as nuk të tha asgjë, kishim vetëm pyetje dhe në qoftë se ke përgjegj, atëherë na jep. Por me na ofendue atë nuk mundësh, z. Qamil. Po ta them për herë të fundit, të lutem ndale këtë praktikë, se kjo është shumë e keqe. Edhe ty po të drejtohem kryesues kur të dalin prej rendit të ditës, sepse është shumë lehtë me ia ndal një minoriteti fjalën, Balldzit, pa e ofendu askënd. Unë kam vërejtje për ty që me ia ndal fjalën atëherë kur ta dalin prej rendit të ditës. Dhe kur të ofendojnë kolegë asamblist këtu. Ju faleminderit.

Resul Fetahu: A do dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë, e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Konstatojmë se me 11 vota për, 9 kundër dhe 0 abstenime, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e pestë: Propozim për bartjen e mjeteve vetanake të pa shpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026. A do dikush tjetër me marrë fjalën?

Zgjim Fejza: Përshëndetje për të gjithë! Në pikën e pestë të rendit të ditës, lidhur me propozimin për bartjen e mjeteve vetanake të pa shpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026, po e shoh se subvencionet në bujqësi janë paraparë në shumën prej 32.000 euro, ndërsa në anën tjetër akoma nuk janë lëshuar subvencionet për ushqimin e kafshëve të vitit 2025, ku përfitues janë përafërsisht 250 fermerë. Disa prej tyre më kanë kontaktuar dhe më kanë pyetur për vonesën e shpërndarjes së këtyre mjeteve. Dhe a janë këto 32.000 euro mjete shtesë për vitin 2026, apo kanë me u përdor për me u zëvendësue mjetet që nuk janë shpërndarë për vitin 2025? Ju faleminderit.

Usmen Baldzi: Shpesh këtu problemi është se propozuesi — në këtë rast kryesuesi — në materialin që na është dhënë nuk jep informacion të mjaftueshëm. Nuk shihet qartë si, pse, për çfarë arsye dhe në çfarë mënyre janë shpërndarë këto mjete, kujt i dedikohen dhe për çfarë nevojash. Kjo thjesht mungon në arsyetim. Gabimi i dytë është që propozuesi nuk e sqaron këtë

as këtu, gjatë seancës — nëse tashmë nuk është bërë në materialin e shkruar — që të shpjegojë për çfarë mjetesh bëhet fjalë, nga vijnë, pse ndahen dhe mbi çfarë baze. Prandaj tani do të përpiqem, pasi shpesh nuk kam mundësi të marr fjalën, që vetë t'i interpretoj këto zëra — edhe pse, sinqerisht, nuk mund t'i kuptoj plotësisht. Në pikën dy, konkretisht në tabelën nr. 1, zëri 621 — “shërbime kulturore”, janë paraparë subvencione. Dje në komitet, si dhe në biseda jozyrtare, kam dëgjuar se rreth 20.000 euro ndahen për komunitetin joshumicë për nevoja kulturore. A ishte e arsyeshme ajo për të cilën kam kundërshtuar gjatë shqyrtimit të raportit financiar — kur nuk kam qenë për miratimin e tij? Konkretisht, kam theksuar se 24% e subvencioneve për nevoja kulturore janë ndarë për komunitetin e Gorës, përkatësisht për komunitetet joshumicë, në vend të 39% që u takon. Tani le ta sqarojmë — nuk mund ta quajmë këtë kompensim, sepse nuk mund të kompensohet nga diçka që është e përbashkët. Të hyrat vetanake janë të përbashkëta dhe përbëjnë një kategori të veçantë; nuk mund të “kthehet” diçka që tashmë është shpenzuar. Aq ekonomi e dimë të gjithë — edhe unë jam ekonomist dhe nuk dua të keqkuptohem. Këtu nuk jemi në garë. Ne jemi përfaqësues të partive politike dhe të qytetarëve, prandaj gjërat duhet të jenë të qarta. Nëse mjetet tani “kthehen” sepse vitin e kaluar janë dhënë më shumë për komunitetin shumicë dhe më pak për atë joshumicë, atëherë kjo duhet të thuhet qartë. Dhe nëse po kthehen 20.000 euro, ndërkohë që bëhet fjalë për mjete të vitit të kaluar, atëherë sipas kësaj logjike shuma do të duhej të ishte 40.000, jo 20.000. Sa i përket bujqësisë, kolegu tashmë e ka ngritur pyetjen, kështu që nuk dua të përsërisem. Kur bëhet fjalë për planifikimin urban, inspektoratin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen, përkatësisht filtrimin e ujësjellësit — kryetari këtu ka deklaruar qartë, dhe madje e kam lavdëruar, se ujësjellësi në Radeshë, si projekt i përbashkët, ka përfunduar. Këtë e keni deklaruar edhe mua personalisht, edhe në media, edhe këtu në Kuvend. Megjithatë, tani rezulton se nuk është kështu, pasi parashihen edhe 61.000 euro shtesë nga mjetet vetanake për të njëjtin ujësjellës. Nëse nuk kam të drejtë, do ta pranoj shpjegimin tuaj — nuk ka asnjë problem. Më tej, sa i përket arsimit të mesëm, kjo është në rregull. Kam punuar në shkollë të mesme dhe është e saktë që kemi fluks nxënësish dhe që tualetet janë në gjendjen që janë, kështu që këto investime janë të arsyeshme. Sa i përket shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor, nuk kam asnjë arsyetim. Nëse përpiqem të them diçka, menjëherë keqinterpretohet — sikur jam kundër dikujt apo diçkaje. Por këtu çështja është e thjeshtë: për cilat shërbime bëhet fjalë? Ja si shkruan në material — “shërbime të kujdesit parësor shëndetësor, mallra dhe shërbime, 15.200 euro”. Çfarë përfshin saktësisht kjo shumë? Cilat mallra dhe cilat shërbime? Këtë pyetje nuk e bëj as si opozitë, as si pozitë — por si këshilltar që dëshiron të dijë për çfarë voton. A mundet

dikush nga këshilltarët apo nga përgjegjësit ta shpjegojë këtë? Sepse kështu duket sikur duhet vetëm të ngremë dorën, pa e ditur për çfarë po votojmë. Kjo nuk është në rregull. Ja, unë jam i gatshëm ta mbështes, por pa një arsytim të qartë vërtet nuk e di për çfarë po votoj. Ju lutem, kur përgatitni materialin, bëjeni në mënyrë të plotë dhe bindëse me argumente që ta mbështesim. Nuk e them këtë me qëllim të keq. Por kam përshtypjen se sapo them diçka, përballem me reagime, ndërprerje dhe mohimin e fjalës. Kjo nuk është korrekte. Njerëz, unë jam këtu me qëllim të mirë. Nëse kjo nuk është e pranueshme, atëherë mund edhe të mos marr pjesë në diskutim — madje edhe ta bojkotoj këtë Kuvend. Nuk mund të hesht për shkak të qytetarëve — jo për vete, por për ta. Prandaj kërkoj që gjërat të na shpjegohen qartë, që të dimë për çfarë po votojmë. Në fund, po kthehem sërish te shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor. Kemi një zë, pastaj edhe një tjetër — por pa shpjegim të qartë se çfarë përfshijnë. Nëse është vërtet e nevojshme dhe nëse na bindni me argumente, ne do të votojmë. Në fund të fundit, nuk duhet të jemi të gjithë pro — ju e keni shumicën — por është obligimi juaj ta arsyetoni. Në të kundërtën, duket sikur po flasim për mjete të mëdha, ndërsa qytetarët nuk e dinë ku shkojnë. Nuk është shumë e vogël — nga 154.000 euro, pothuajse të gjitha shkojnë për shërbime për komunitetin shumicë, ndërsa për komunitetet joshumicë nuk ka asgjë. Dhe tani, kur e them këtë, del sikur po sulmoj komunitetin shumicë. Jo — nuk sulmoj askënd. Vetëm kërkoj që, kur shpërndani mjete, t'i shpërndani në mënyrë të drejtë. Respektoni përqindjen prej 39% që kemi miratuar. Dhe jo vetëm në investime kapitale — zbatojeni edhe për mallra dhe shërbime, si dhe për paga. Respektoni buxhetin. Vazhdimisht i theksoj këto gjëra me qëllim të mirë, dhe pastaj vendimet na kthehen nga Prishtina. Dhe kur lind problem në buxhet, fajtori kërkohet në drejtim të gabuar — në vend që të përballemi me thelbin. Ne këtu, si Kuvend, kemi të drejtë të flasim, të shkëmbejmë mendime dhe të garojmë në mënyrë demokratike me argumente. Pushteti ekzekutiv nuk mund të marrë vendime pa arsytim të qartë dhe pa e respektuar Kuvendin. Dihet kush është pushteti ekzekutiv në Komunën e Dragashit, dhe dihet edhe roli i Kuvendit. Ne jemi këtu për të vendosur rregulla, kritere dhe për të siguruar shpërndarje të drejtë. Përndryshe, vijmë në situatë që debatojmë pa nevojë. Komuna e Dragashit është e njohur për tolerancë dhe respekt të ndërsjellë — dhe duhet të mbetet e tillë. Prandaj ju lutem: na e shpjegoni qartë propozimin. Kush është propozuesi? Nëse jeni ju, kryesues, apo nëse vjen nga kryetari i komunës, le të sqarohet saktë që të dimë për çfarë po votojmë. Nëse 20.000 euro janë të dedikuara për komunitetet joshumicë, atëherë sipas kësaj logjike shuma duhet të jetë 40.000, nëse po bëhet korrigjim për vitin e kaluar. Ka kaluar — në rregull, ka qenë si ka qenë, unë atëherë kam

qenë kundër, por kjo tani nuk është thelbësore. Nëse tashmë po e ktheni, kthejeni siç duhet. Nuk mund ta bëni këtë nga mjetet vetanake që janë të përbashkëta — është i njëjti buxhet, i njëjti “xhep”. Për këtë nuk nevojitet ndonjë analizë e madhe ekonomike për ta kuptuar.

Samidin Xheladini: Parafolësi çfarë ka dashur të thotë unë nuk e di, por dua ta sqaroj, sepse ju e keni dokumentin përpara. Ai është shprehur kështu disa herë, me sa unë e kam marrë vesh. pakica, manjina ose veçina, shumicë. Domethënë, komuniteti jo shumicë dhe komuniteti shumicë. Unë këtë dokument me sa po e shoh, në opinion mos plaso këso fjalë të pavërteta, sepse unë nuk e pranoj. Këtu në këtë dokument shkruan, subvencionet dhe shërbimet kulturore 20 mijë euro, subvencionet në bujqësi 22 mijë euro, planifikimi urban dhe inspekcioni i kanë të parapara 61 mijë euro, ndërtimi i impiantit dhe pastrimi i ujrave të lumit në Radesh, te burimi i lumit të fshatit Radesh. Domethënë, i vetmi pozicion që përfshinë komunitetin jo-shumicë. Përsëri shkojmë tek shërbimet shëndetësore primare, 19 mijë euro. Pastaj shkolla Rushdi Berisha, ajo është e të gjithëve. Shërbimet shëndetësore primare, domethënë, mallra dhe shërbime, 15 mijë, renovimi i QKMF-së. Unë nuk po shoh këtu diskriminim. Unë po shoh këtu diskriminim pozitiv dhe mua po më vjen keq sepse ne jemi duke folur për këtë dokument. Në pikën eventuale mund të parashtrosh ato shqetësime të cilat i ke dhe ne nuk mund të biejm nën hijen e diçkaje e cila nuk është e vërtetë. Fol me fakte dhe trego realitetin për çka dhe ku e ke shqetësimin. Nëse nuk është kjo dhe komuniteti i jo-shumicës mendon se po bëjmë politikë diskriminuese, por në fakt është e kundërta. Dhe unë nuk dua të ndëgjoj këso diskutime. Sepse kjo është asambleja komunale, është organ më i lartë i Komunës dhe është publike dhe seanca është publike dhe ne i mbrojmë interesat e të gjithë qytetarëve, jo shumica e pakica.

Usmen Baldzi: Një pjesë e fjalimit tim ishte plotësisht profesionale, ekonomike dhe administrative. Në këtë propozim ne nuk e shohim pse, për çfarë arsye dhe ku po shpërndahen mjetet. Ndërsa fakti që dikush nuk dëshiron ta shohë është çështje tjetër — këtu thjesht nuk shkruan. Kryesuesi nuk na e ka arsyetuar këtë. Ndoshta tani kryetari i komunës do të japë shpjegim dhe mund të ndryshojmë mendim — gjë që është në rregull. Por që në vetë materialin të ekzistojë një arsyetim i qartë: çfarë, ku dhe si — nuk ka. Fakti që ngrini tonin dhe përpjekjet për të ndikuar në këtë mënyrë tek unë nuk janë të pranueshme. Kjo këtu nuk kalon. Ky Kuvend ka shumicë dhe pakicë — dhe kjo është fakt. Në komunën e Dragashit komunitetin shumicë e përbëjnë shqiptarët, ndërsa komunitetet joshumicë janë boshnjakët, goranasit dhe të tjerët. Këtë të gjithë e dimë dhe duhet ta respektojmë. Gjithashtu përmendet shuma prej 20.000 euro për nevoja të caktuara — dhe

kjo është informacioni që kemi. Supozoj se kryesuesi do ta konfirmojë dhe do ta sqarojë më tej. Ju po ktheni jo 20.000 për shërbime kulturore — vitin e kaluar kemi marrë 24% nga subvencionet për kulturë dhe sport. Këtë e kam lexuar, e kam shpjeguar, por asgjë nuk më jepet. Çfarëdo që kërkoj — asgjë. Kryesuesi e vë në votim dhe kaq. Kjo është e vërteta. Ky Kuvend është publik dhe qytetarët duhet ta dinë. Unë nuk sulmoj komunitetet, as shumicën as pakicën. Unë mbroj interesat e komuniteteve joshumicë dhe për këtë arsye nuk e bojkotoj këtë Kuvend — përndryshe do të ishte bojkot i plotë. A duhet patjetër të jetë kështu: nënshkruaj, merr pagën dhe mbaron puna? Kam thënë — duket sikur këtu nevojitet vetëm letërnjoftimi. Dikush flet, dikush hesht dhe në fund të gjithë marrim pagën. Kërkoj shpjegim. Këto subvencione prej 26.000 eurosh — pse nuk janë paguar në vitin 2026, kur konkursi ka qenë në vitin 2025 dhe janë bërë procesverbalet për fondin blegtoral? Pse nuk janë paguar në vitin 2025? Unë nuk jam kundër subvencioneve. Dhe në fund, 39% për mallra dhe shërbime — kjo duhet të vlejë edhe për punësimin. Nëse është punësuar 20%, atëherë edhe mallrat dhe shërbimet duhet të shpenzohen 20%, jo 39%. Unë jam ekonomist i mirë, kam qenë drejtor i ekonomisë.

Bexhet Xheladini: Lidhur me propozim vendimin për bartjen e mjeteve vetanake të pa shpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026, ju e dini të gjithë, shumica jeni ekonomista, por jeni edhe shumë vjetër asambleist dhe dini që të hyrat vetanake të cilat nuk mund të shpenzohen nga viti paraprak, nga viti i kaluar, ato nuk humbin dhe komuna i kthehen prapë. Ato mjete pastaj komuna ka të drejtë ti orientojë në projekte të ndryshme. Por është me ligj që të hyrat vetanake, të cilat nuk janë shpenzuar vitin e kaluar, nuk mundesh t'i destinojsh ku të duash ti. Në bazë të ligjit duhet, ato mjete të cilat nuk i ke shpenzuar për shembull në ndonjë projekt, duhet patjetër ato mjete me i que te ai projekt, do të thotë duhet në të njëjtin program. Ndërsa të hyrat vetanake të cilat grumbullohen më shumë sesa planifikimi, ato mjete kryetari i Komunës i propozon asamblesë dhe i orienton tek ekzekutivi, do të thotë sipas nevojës. Kështu që për këtë propozim projekt unë dua të sqarojë, për hir të informimit të drejt të opinionit, Usman Baldzi doli dy herë dhe tha këtu dhe unë e di se ai është një ekonomist shumë me përvojë dhe e din këtë gjë, po më vjen keq që po do me e keqpërdor këtë foltore dhe me bo njëfarë ndarësie, kuse ne nuk po i ndajmë mjetet në mënyrë proporcionale, gjë që nuk është e vërtetë. Ne jemi komunë shembull në Kosovë, sa i përket ndarjes proporcionale të buxhetit. Në shërbimet kulturore na janë grumbulluar më tepër mjete. Dhe ne i kemi orientuar në subvencionet të kulturës, të cilat subvencione janë, do të thotë, shpenzime të përbashkta. Nuk janë të komunitetit as shumicë, as të komunitetit pakicë. Do të thotë janë subvencione të cilat do

t'i marrin të gjitha OJQ-të edhe nga treva e Gorës dhe nga treva e Opojës, të cilat do të konkurrojnë apo aplikojnë. Ne e kemi bërë thirrjen publike dhe do të ndahen. Po ashtu edhe vitin e kaluar në raportin vjetor të kryetarit të Komunës, të ekzekutivit e kemi sqaruar. Vitin e kaluar të gjitha OJQ-të nga regjioni i Gorës, të cilat kanë aplikuar për subvencione të gjitha kanë marrë subvencione, shuma pra është nga katër mijë deri në gjashtë mijë euro. Mirëpo, ka projekte kulturore të cilat nuk janë as të shumicës, as të pakicës. Sikur për shembull pjesën më të madhe të mjeteve e merr Klubi Futbollistik Opoja. Klubi Futbollistik Opoja nuk është klub futbollistik i Opojës. As nuk është i Gorës. Është klub i komunës së Dragashit dhe ato nuk duhet të hynë në ndarje proporcionale. Ato janë shpenzime të përbashkëta. Gjithashtu, festivali ballkanik Opoja Vallzon është projekt i komunës ku marrin pjesë së paku çdo vit nga njëmbëdhjetë shtete të Ballkanit dhe të Evropës në këtë manifestim. Sa i përket bujqësisë 32 mijë euro subvencione në bujqësi. Për arsye se kemi mbledh më shumë mjete se vitin e kaluar 32 mijë euro subvencione në bujqësi, ndërsa sa i përket 61 mijë euro për ndërtimin e impiantit të ujësjellësit. Siç e dini, ju vitin e kaluar Ministria përkatësisht, thesari nga projekti i ujësjellësit. Na i ka marrë gjysmë milioni euro për pagesën e kontratës kolektive, kështu që ne kompanive të cilat kanë punuar në të tri llojet e ujësjellësit, ju kemi mbetur borxh afër pesëqind mijë euro. Në buxhetin e këtij viti, ne ato mjete i kemi paraparë dhe pjesë e atyre mjeteve janë edhe gjashtëdhjetë e një mijë euro dhe këto janë shpenzime të përbashkëta. Ujësjellësi për pesëmbëdhjetë fshatra është shpenzim i përbashkët. Nuk është as i Gorës, as i Opojës. Sa i përket ndërtimit të nyjeve sanitare, është projekti në ndërtim e sipër, nuk ka mundur të përfundojë vitin e kaluar. Ne për mos t'i humbur mjetet e grantit, punët të cilat janë kryer i kemi paguar me mjetet e grantit, kurse punët të cilat kanë mbetur pa kryer i kemi ruajtur mjetet e të hyrave vetanake. Kështu që këtë vit ai projekt po përfundon dhe këto 20 mijë euro do t'a bëjmë pagesën. Sa i përket shërbimeve ku afër 16.000 euro, të cilat janë ndarë të cilat janë shërbime primare shëndetësore, gjegjësisht mallra dhe shërbime, këto mjete kanë qenë në buxhetin e vitit të kaluar të parapara nga të hyrat vetanake për mallra dhe shërbime në shëndetësi dhe këto ne patjetër, sipas ligjit të buxhetit, këto mjete është dashtë që patjetër të orientohen në shëndetësi për mallra dhe shërbime. Nëse nuk beson mund të hyh në buxhetin e vitit të kaluar, ku 15.000 euro kanë qenë të parapara për mallra dhe shërbime nga të hyrat vetanake, sepse sipas ligjit të hyrat vetanake nuk mundesh t'i shfrytëzosh të gjitha vetëm për investime kapitale, por duhet një pjesë ta orientosh në arsim, një pjesë në shëndetësi dhe një pjesë në komunë. Renovimi i objektit të QKMF-së në Dragash, 6.000 euro. Do të thotë është një projekt në vazhdim e sipër ndërtimi i shkallëve,

do të thotë na ka mbetur një pjesë e shkallëve. Do të thotë këto janë mjete të cilat janë mbledh më shumë sesa planifikimi, do të thotë të gjitha mjetet e të hyrave vetanake nuk i kemi vendos as për shqiptarët, as për boshnjakë-goranët. Pra i kemi vendos në projekte të përbashkëta dhe realisht 60% janë ndarë nga mjetet e shumicës dhe 40% nga mjetet e pakicës dhe janë quar në projektet e investimeve të përbashkëta, kështu që nuk ka kurgjë diskriminuese dhe çdo gjë është në rregull dhe unë gjithmonë e kam si detyrë, sa i përket ndarjes së drejtë, unë nuk dua askujt t'i hy në hak. Është e njëjtë sikur dikuj me ia marrë paratë prej xhepit. Në këtë rast, është njëjtë si kur meja marrë komunitetit pakicës dhe me ia dhanë shumicës. Unë një gjë të tillë nuk e kam bërë kurrë dhe nuk do ta bëj përderisa jam kryetar, por mirë është këtu mos me bo politikë për ndarje të drejtë të mjeteve financiare, sepse këtu nuk mundesh ta gjejsh asnjë gabim. Ju faleminderit.

Usmen Baldzi: Pra, rezulton se kam pasur të drejtë. Propozuesi — në këtë rast kryetari i komunës — është dashur që në fillim të kësaj pike të rendit të ditës të dalë dhe t'i arsyetojë të gjitha këto që i tha tani. Tani gjërat janë disi më të qarta — por vetëm pjesërisht. Në fillim pothuajse asgjë nuk ishte e qartë, sepse në material mungonte arsyetimi i nevojshëm. Prandaj mendoj se është e rëndësishme që në të ardhmen, kryesues, për propozime të tilla, fillimisht propozuesi të japë një arsyetim të qartë dhe të plotë, e pastaj ne, anëtarët e Kuvendit, të shqyrtojmë dhe të diskutojmë. Sa i përket shërbimeve kulturore, zoti kryetar, nuk mund të pajtohem plotësisht me ju. Këto 20.000 euro, siç e shpjeguat, shkojnë nga të hyrat vetanake në subvencione. Vetëm pas konkursit dhe shpërndarjes së mjeteve do të shohim nëse kjo është vërtet e drejtë apo jo. Vitin e kaluar, kur bëhet fjalë për shërbimet kulturore dhe subvencionet, nuk ka pasur shpërndarje të drejtë (“fair share”). Të sqaroj për të gjithë anëtarët e Kuvendit, si dhe për qytetarët që na ndjekin: shpërndarja “fair share” e buxhetit do të thotë që buxheti i komunës së Dragashit — i përbërë nga mjetet e pushtetit qendror dhe të hyrat vetanake — të shpërndahet në përputhje me numrin e banorëve. Në fund të fundit, edhe vetë Kuvendi është zvogëluar nga 27 në 21 anëtarë pikërisht në bazë të numrit të banorëve. Sipas kësaj logjike, pjesëmarrja e komuniteteve joshumicë në komunën e Dragashit është rreth 39,7%, pra afërsisht 40%. Ky përqindje, në kuadër të parimit “fair share”, i referohet të gjithë buxhetit. Nëse nuk kam të drejtë, e ftoj drejtorin, si ekonomist, të më korrigjojë. Nuk ka të bëjë vetëm me investimet kapitale. Sa i përket investimeve kapitale, komuna e Dragashit për shumë vite ka qenë relativisht korrekte në shpërndarjen “fair share” ndërmjet pjesëve të ndryshme të komunës. Këtu nuk kam vërejtje të mëdha — dhe këtë e kam thënë qartë. Vetëm kërkoj të dimë ku shkon çdo euro. Por kur bëhet fjalë për kategori të tjera, shtroj një pyetje konkrete: a kam të

drejtë, drejtor i financave, që parimi “fair share” vlen për të gjithë buxhetin — pra edhe për mallra dhe shërbime, edhe për paga, si dhe për investime kapitale? Për investimet kapitale them se gjendja është kryesisht në rregull. Megjithatë, kur bëhet fjalë për paga — aty gjendja nuk është në rregull. Numri i të punësuarve nga komunitetet joshumicë është dukshëm nën përqindjen që u takon. Kohët e fundit kemi shembuj punësimi në ambulancë — 3–4 të punësuar të rinj, pa pasur informacione të qarta se kush janë, nga vijnë dhe si janë pranuar. Të jem i qartë — nuk po sulmoj komunitetin shumicë dhe nuk po flas për ndonjë lloj segregimi. Kur bëhet fjalë për sigurinë dhe bashkëjetesën, situata është e mirë. Por kur bëhet fjalë për përfaqësim të barabartë dhe zbatimin e parimit të shpërndarjes së drejtë — këtu gjërat nuk janë në rregull. Nëse numri i të punësuarve është më i vogël, atëherë edhe shpenzimet janë më të vogla — më pak material, më pak letër, më pak ngrohje, më pak energji elektrike. Pra, më pak mjete shkojnë për mallra dhe shërbime. Në këtë pjesë nuk pajtohem me kryetarin. Sa i përket FK Opoja, le të dalë dikush dhe ta thotë qartë: FK Opoja është në kuadër të komunës së Dragashit. Edhe unë kam qenë atje dhe e di mirë për çfarë flas. Të jemi realistë — FK Opoja nuk ka lidhje me Gorën. Nëse gabo, jam i gatshëm të kërkoj falje. Ky është Kuvend dhe këtu duhet të flitet saktë. Nëse marrin pjesë edhe goranë në aktivitete të caktuara, kjo është në rregull dhe duhet të thuhet. Por emri dhe identiteti janë të qarta — është FK Opoja. Për shembull, kur flasim për shoqërinë kulturo-artistike “Opoja Vallzon”, ajo nuk është shoqëri e përbashkët. Mos i përziejme gjërat. Ju lutem të jemi të saktë dhe korrektë në këto çështje. Nëse është kështu, atëherë do të ishte edhe “Vlaška opojane” — por as në atë rast kryetari nuk ka të drejtë. Sa i përket planifikimit urban dhe ndërtimit, e kam thënë tashmë — kush e di kur do ta përfundojmë ujësjellësin në Radeshë. Për sa kohë që vazhdimisht ndahen mjete shtesë, ai projekt do të zvarritet. Po vijmë në një situatë absurde që ujësjellësin po e ndërtojmë nga viti 1999 deri në vitin 2026. Unë dhe Qamili kemi qenë ndër ata që kemi marrë pjesë që në fillim, dhe me këtë ritëm duket se do ta përfundojmë kur të mos jemi më. Sa i përket arsimit të mesëm, aty nuk kam vërejtje — është praktikisht e vetmja fushë ku gjërat janë bërë siç duhet. Prandaj është e vetmja pikë në Dragash ku gjërat janë vërtet të mira — shkolla e mesme. Ne dhe kolegët kemi punuar më shumë se 20 vjet aty dhe rezultatet janë të dukshme. Sistemi funksionon siç duhet. Sa i përket shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor, tani më keni bindur — e pranoj arsyetimin dhe do të votoj pro. E njëjta vlen edhe për pikat e tjera të lidhura. Ja, kështu duhet të funksionojë Kuvendi — përmes argumenteve dhe shpjegimeve, jo përmes keqkuptimeve dhe tensioneve. Nuk ka nevojë për

konflikte. Dhe sa i përket “Opoja Vallzon” — me kënaqësi do të vij dhe do të marr pjesë në aktivitetet, por të jemi të saktë: është opojare dhe jo nga Gora.

Danis Hodza: Përshëndetje të gjithëve. Më falni nëse ndoshta dal pak nga tema, por disa herë po dëgjoj këtu që theksohet ndarja në shumicë dhe pakicë. Le të mos ndajmë veten. Qytetarët e kësaj komune jetojnë së bashku dhe duhet të vazhdojnë të jetojnë së bashku me respekt të ndërsjellë. Është detyra jonë të punojmë në interes të të gjithë qytetarëve. Prandaj ju lutem edhe një herë që të mos insistohet në ndarje në shumicë dhe pakicë. Faleminderit.

Zgjim Fejza: Unë më herët i bëra dy pyetje nëse ka mundësi një sqarim për ato dy pyetjet, lidhur me subvencionet e ushqimit të kafshëve të vitit 2025 të cilat janë vonuar dhe për 32 mijë euro, a kanë me u përdorë si shtesa apo si zëvendësim?

Shukri Myrtezani: Përshëndetje për të gjithë! Pasi që edhe unë vet jam fermer edhe mua më kanë bërë shumë kolegë fermer për çështjen e pagesave të subvencioneve të Komunës. Ne e kemi diskutue çështjen e pagesave me kryetarin e Komunës, ato mjete kanë me u pague në fund të muajit dhe garantojmë që secili fermer do t’a marrë atë pagesë por do të ketë edhe subvencione në vitin 2026 dhe ato mjete do ti marrin gjatë vitit 2026, kështu që fleni rahat se kurdo që ti merrni parat ju duhen. Ju faleminderit.

Resul Fetahu: Faleminderit! A do diksuh tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 17 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, miratohet edhe kjo pikë. Atëherë, vazhdojmë me pikën eventuale. Kush do me e marrë fjalën në pikën eventuale?

Granit Rifaj: Unë e kam një pyetje për kryetarin, ku na ka ardhë një vendim i gjykatës për z.Fitim Karimani për rikthim në punë dhe i shpallë vendimet e QKMF-së dhe komisionit komunal si të jashtëligjshme dhe e obligon Komunën me e kthye në vend të punës. Ju ende nuk e keni kthyer, dua një përgjigje sepse ka publikuar zotëria në rrjete sociale edhe biseda private që i keni thënë keni me i rrespektue vendimet. Pyetja tjetër, kanalet në rrugën e ujësjellësit që kanë qenë në fshatin Kapre, herën e parë i kam prezentue këtu dhe më keni thënë se nuk është ashtu dhe e kam dokumentuar dhe drejtori në fjalë mundet me tregue që janë ashtu. Keni marrë masa, desha të ju falendëroj i keni mbyllur kanalet dhe kanë fillue me rrugën me punue. Pastaj më keni mbetur borgj prej herës së kaluar veç kryetari i Komunës i ka sjell se çka është punuar, për rrugën Kosavë që e keni pranur edhe vetë që nuk ka pasur punime kualitative dhe nuk janë kryer krejta. Për stadiumin

e Pllavës dhe të Blaçit nuk më keni dhënë përgjigjet në qoftë se ka mundësi këtë seancë. Ju faleminderit!

Usmen Baldzi: Të nderuar, Nën pikën “të ndryshme” do të doja të hap disa çështje për të cilat kjo Kuvend, në të ardhmen, duhet të diskutojë, ose së paku të marrim informacione të qarta për publikun. Së pari, dua të rikujtoj se në mbledhjen e kaluar të Kuvendit është pranuar nga kryesuesi që Zyra për Komunitete të paraqesë raport për punën e saj. Për këtë është diskutuar edhe në komitet. Sipas rregullores së punës së Zyrës për Komunitete, parashihet që një raport i tillë t’i dorëzohet pikërisht këtij Kuvendi, e jo vetëm kryetarit të komunës, siç po ndodh aktualisht. Kjo është obligim i tyre i përcaktuar me rregullore. Prandaj mendoj se është e rëndësishme që ky obligim të përmbushet dhe Kuvendi të marrë raportin e plotë për shqyrtim. Çështja e dytë ka të bëjë me situatën në Radeshë. Para disa ditësh kemi pasur protesta të banorëve lidhur me furnizimin me ujë, përkatësisht lidhjen në rrjetin elektroenergjetik. Nuk dua të gaboj në emërtim, por bëhet fjalë për stacionin e ujit dhe furnizimin e tij me energji elektrike. Sipas informacioneve që kam, banorët e Radeshës nuk pajtohen që energjia elektrike për këtë qëllim të merret nga trafostacioni në Radeshën e Poshtme. Ata konsiderojnë se kjo duhet të zgjidhet ndryshe, sepse ai objekt, sipas asaj që kam kuptuar, ka ose duhet të ketë furnizim të vetin, përkatësisht infrastrukturë adekuate. Prandaj kërkoj të marrim një përgjigje të qartë: cili është zgjidhja konkrete, çfarë është ndërmarrë dhe cila është gjendja aktuale në Radeshë? Çështja e tretë ka të bëjë me informacionet për të punësuarit në komunën e Dragashit. Mendoj se është koha e fundit që unë, përkatësisht Kuvendi, të marrë të dhëna të sakta për emrat dhe numrin e të punësuarve në të gjitha linjat buxhetore — në shëndetësi, administratën komunale dhe në të gjithë sektorët e tjerë që funksionojnë në kuadër të komunës së Dragashit. Këto informacione i kam kërkuar edhe më herët, por deri tani nuk i kam marrë. Në fund, mendoj se do të ishte shumë e dobishme që Drejtoria e Shëndetësisë, si dhe Zyra për Komunitete, ta informojnë Kuvendin se kujt po i ndahen shtëpitë në kuadër të programit social. Sa i përket Qendrës për Punë Sociale, si dhe donacioneve nga Ministria për Kthim dhe burime të tjera që janë të përfshira, e sidomos në lidhje me Zyrën për Komunitete — ende nuk kemi informacione të plota dhe të qarta. Në fund, është mirë të thuhet se jetojmë së bashku, por kjo është dashur të thuhej edhe para 26 vitesh, jo vetëm tani. Dikush ka jetuar dhe punuar gjatë gjithë këtyre viteve në atë kontekst, ndërsa sot sërish jetojmë së bashku. Zoti Hodža, komunitetet joshumicë ekzistojnë edhe në Kosovë, dhe ato ekzistojnë edhe në komunën e Dragashit. Së bashku jetojmë vetëm në Dragash. Zoti ka vendosur që të jetojmë në rajone të ndara. Ne jetojmë këtu prej kohësh

dhe do të vazhdojmë të jetojmë së bashku — me ose pa ty, me ose pa mua. Por mos më flisni me ato fraza politike. Unë këtu, para së gjithash, kujdesem për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë, dhe nëse vjen momenti që duhet të mbrohet edhe interesi i komuniteteve joshumicë dhe bashkëjetesa, unë jam i pari — dhe do ta mbroj edhe atë.

Danis Hodza: I nderuar z. Baldži, para së gjithash, atë apel nuk e kam drejtuar personalisht ndaj jush — ju vetë e keni gjetur veten aty. Kjo vlen për të gjithë. Vlen edhe për mua personalisht. Nëse ju e keni marrë për vete dhe ndiheni i fyer, ju kërkoj falje.

Artan Loshaj: I nderuar kryetar, edhe dje në Komitet kemi diskutuar për çështjen e ujit të pijshëm të qytezës së Dragashit, fshatit Pllavë, Brezne edhe një pjesë të fshatit Shajne aty poshtë ku i thojnë fusha, këta janë të kyçur në ujësjellësin qëndror dhe bëjnë pagesë rregullisht në Hidroregjion. Ndërsa me këtë ujësjellës të ri para zgjedhjeve u bë një aferë e madhe për 15 fshatëra dhe qytezën, a ka mundësi me na njoftue deri ku ka mbërri uji, sa fshatëra janë të kyçur sepse unë e di, jetojë në Dragash dhe jemi me sistemin e vjetër edhe ata fshatëra që janë të kyçura në sistemin e ri, unë i di dy apo tri fshatëra, ndoshta jam gabimë Brruti, Zgatari dhe Kapre, a bëjnë pagesë të ujit? Kujt i bëjnë pagesë, a kanë orë? Sepse qytetarët të cilit bëjnë pagesë, ku njëri prej tyre jam edhe unë, jemi të shqetësuar e sidomos fshatarët e fshatit Brezne, i keni edhe nëpër rrjete sociale, se si është e mundur kryetari i Komunës kur është kryetar i të gjithë qytetarëve të bëjë standarde të dyfishta, Dragashi, Brezne, Pllava dhe gjysa e Shajnës paguajnë ndërsa... nuk jam kundër absolut këtyre tjerëve, në qoftë se bëni pagesë ju për këta, bëne edhe për këta të tjerit. Dje kam kërkuar që këtu të jetë prezent edhe drejtori apo menaxheri i Hidroregjionit, nuk e ke pas vullnetin unë e di pse, qytetarët ne t'a marrin vesh vetë, unë spo due me ndërhy mes juve, nuk ke pasur vullnet që sot t'a sjellish drejtorin ose menaxherin këtu dhe ta diskutojmë dhe qytetrë t'a kuptojnë pse është ky standard i dyfishtë? Kjo nuk është hera e parë sepse standarde të dyfishta keni bërë ndaj qytetarëve edhe me mbeturina, 8-9 fshatëra që ju ke bërë pagesën në Ekoregjion, ke bërë anashkalime ku p.sh.: unë dhe disa fshatëra të tjera që e bëjmë pagesën, e disa fshatërave j'au ke paguar ti dhe mirë ke bërë, por qytetarët kërkojnë përgjigje. Tjetra, përsëri në lidhje me ujin, tash po folim vetëm për qytezën. Dragashi e di ti që ka shumë probleme, ujësjellësi i Dragashit është i viteve të 60, është me azbestë dhe je vetë mjekë, është i dëmshëm për pije. Kur bjen shi, ai ujë nuk është i pijshëm. Po j'au bëjë një pyetje juve që punoni këtu dhe të gjithë pas orës tre shkoni në Opojë dhe nuk e keni provuar dhe nuk ja dini as shijen se çfarë e ka!? Ne detyrohemi të bljemë ujë kur bjerë shi edhe pse jemi në lartësi mbidetare mbi 1200 m. Dua t'a bëjë një kërkesë që këtë vitë,

jemi shumë herët, ende nuk keni bërë planifikim të buxhetit që t'a kemi parasyshë që në vitin 2027 t'a futim në buxhet ndërrimin e kanalizimit dhe ujësjellësit të Dragashit. I vetmi qytetë, ku pas luftës, nuk është investuar asnjë send, të gjithë qytetet e Kosovës kanë investime e kurse Dragashi jo, këtë vërejtje nuk po j'au bëjë juve sepse jam asamblesitë disa mandate dhe këtë ja kam bërë edhe subjektit tim. Nga PDK-ja kam kërkuar buxhet special për komunën e Dragashit, arsyetimet e juaja dhe të PDK-së janë se në Dragash investohet, po me të vërtetë investohet në Shkollë dhe në Spital ku të gjithë qytetarët marrin shërbime ndërsa qyteza si qytezë është lënë anash. Kam ndërgjuar se këtë mandat do të investoni në Dragash, shpresojë se janë të vërteta sepse deri më sot të gjitha partitë politike pa dallime, qytetarët të cilët jetojmë në komunën e Dragashit na keni shfrytëzuar vetëm për vota, absolut një ndryshim më i vogël në qytezë nuk është. Kërkojë që në buxhetin e vitit 2027 të ndërrohet rrjeti i kanalizimit, rrjeti i ujësjellësit, t'i ndërtojmë ndërtesat edhe kulmet, së paku me ngjyra t'i lyeni, që me të vërtetë komuna e Dragashit është anashkaluar që 27 vite! Ju faleminderit!

Pajtesa Piraj: Përshëndetje për të gjithë! Kam një pyetje për kryetarin, lidhur me stadiumin e Pllavës, a do të fillojnë punimet dhe çka do të bëhet me atë pjesë pasi që ka mbetur në gjendje të keqe? Ju faleminderit!

Afrore Vejseli: Përshëndetje për të gjithë! Fillimisht duke qenë se pak ditë më parë shënuam ditën e tokës, dua të ndaj një mesazh për të gjithë qytetarët tonë. Toka nuk është vetëm vendi ku jetojmë, është një përgjegjësi që mbartim për çdo ditë. Mënyra se si sillemi me mjedisin na tregon qartë se çfarë të ardhme po ndërtojmë për fëmijët tonë. Fatkeqësisht, realiteti në Komunën tonë nuk është në nivelin që duhet të jetë. Lumenjtë tonë që duhet të jenë burime jete dhe pastërtie në shumë raste janë shëndërruar në vende të mbushura me mbeturina. Kjo gjendje është si pasojë e pakujdesive të qytetarëve por njëkohësisht edhe një neglizhencë e pushtetit lokal për të vepruar në kohë me seriozitet. Nuk mund të kërkojmë ndërgjegjësim nga qytetarët nëse nuk ka një shembull konkret nga veprimi nga institucionet. Andaj, kërkoj që të merren masa të menjëhershme për pastrimin dhe mirëmbajtjen e lumenjëve në Komunën tonë si dhe hartimin e një plani të qartë për parandalimin e ndotjes në të ardhme. Në të njëjtën kohë nuk mund të mos përmend rastin e fundit që ka ndodhur, ku qytetarët tonë janë ngacmuar nga qentë endacak. Këto nuk janë raste të izoluara, janë tregues i një problemi serioz të sigurisë publike. Është e papranueshme që qytetarët të ndihen të rrezikuar në hapësirat e tyre të përditshme, përderisa mungon një reagim i shpejtë dhe efektiv nga institucionet përgjegjëse. Prandaj kërkoj që gjithashtu edhe këtu të merren masa urgjente edhe

konkrete për menaxhimin e qenëve endacak, në mënyrë që të garantohet siguria për të gjithë, sepse kujdesi për tokën dhe mjedisin nuk ndahet nga kujdesi për njerëzit. Nëse dështojmë në këto dy drejtime po dështojmë në përgjegjësit tona para qytetarëve. Ju faleminderit!

Danis Hodza: Përshëndetje të gjithëve. Do të doja t'ia tërheq vëmendjen komunës lidhur me shërbimet shëndetësore në Restelicë. Restelica, si fshati më i madh në komunë, ka shërbime shëndetësore shumë të dobëta. Kemi një ambulantë të mjekësisë familjare me infrastrukturë shumë të dobët dhe me numër të vogël mjekësh. Është e nevojshme të rritet numri i mjekëve në ambulanten e Restelicës, si dhe të ndërtohet një ambulantë e re. Si fshati më i madh në komunën e Dragashit, është e papranueshme që të ketë shërbime kaq të dobëta shëndetësore — kjo është turp për të gjithë ne këtu. Shpresoj që të gjithë së bashku të angazhohemi për ta përmirësuar këtë gjendje. Faleminderit.

Bexhet Xheladini: Sa i përket vendimit, që është marrë për rastin e z.Fitim Karimanit, edhe pse është bërë pyetja se pse Komuna nuk po e zbaton vendimin, sigurisht që zotëria i cili e ka bërë këtë pyetje nuk e dinë që ky vendim nuk është plotëfuqishëm. Në momentin kur ky vendim të bëhet i plotëfuqishëm, Komuna gjegjësisht QKMF-ja do ta zbatojë vendimin e gjykatës ashtu siç thuhet në vendim. Për stadiumin e Pllavës dhe të Blaçit, Graniti përsëri e ka bërë një pyetje, nuk e di, a do dokumentacionin apo të të jap vetëm informata sepse ato stadione janë 2 dhe 3 vjeçar dhe ata janë në punime në vazhdim e sipër dhe stadiumi i Blaçit kryhet këtë vit ndërsa i Pllavës nuk e di a kryhet këtë vit apo vitin tjetër dhe arsyeja pse nuk kanë filluar punimet ende është për shkakë të lagështisë përndryshe këto dy projekte janë të kontraktuara dhe këto dy projekte do të përfundojnë. Z.Usmen Baldzi ka bërë një pyetje se pse Zyra e Komuniteteve nuk e ka paraqitur raportin e punës, siç e dini Zyra e Komuniteteve i përgjigjet kryetarit të Komunës, pra ky raport i Zyrës së K. ka qenë i inkorporuar brenda raportit të kryetarit. Gjithashtu Z.K ma ka dorëzuar në dy gjuhë raportin edhe planin e punës, është një raport jashtë zakonisht i përgatitur profesionalisht dhe unë propozoj që ky raport në Komitetin e ardhshëm të Komiteti për Komunitete t'ju shpërndahet anëtarëve të Komitetit dhe të diskutohet në Komitet dhe aty të merret ndonjë qëndrim se a duhet ky raport të diskutohet edhe në Kuvend. Sa i përket rrymës në fshatin Radeshë, ju e dini që ne kemi pasur probleme me implementimin e projektit të ujësjellësit, arsyeja është sepse projekti i vjetër është përgatit shumë herët dhe gjërat kanë ndryshuar. Ndërsa sa i përket projektit të furnizimit me rrymë të impiantit, sot e kësaj dite impianti është duke punuar me dy gjenerator, arsyeja është mungesa e rrymës. Ka qenë një gabim në përgatitjen e projektit të vjetër, ku ata e kanë paraparë instalimin

e rrymës dhe të rrjetit paushall, nuk e kanë bërë në bazë të terenit qysh duhet dhe sa shtylla dhe ata e kanë paraparë me marrë dikund rrymën shumë afër mirëpo KEDS-i kur e kemi bërë kërkesën me na dhënë lejën e punës, KEDS-i nuk ka pranue me marrë rrymën aty ku ka qenë projekti i qeverisë së kaluar sepse nuk ka rrugë për vendosjen e shtyllave dhe e gjithë pjesa ku është dasht të vendosen shtyllat është pronë private. Kështu që, ata na kanë dhënë lejën e ndërtimit dhe shtrirjes së ujësjellësit që ne me marrë në Radeshë. Për ne kjo ka qenë trefishë më i kushtueshëm se sa projekti i kaluar sepse një pjesë e këtij projekti do të kryhet përmes kanaleve tokësore. Por kemi has në një rezistencë të banorëve të fshatit që edhe ata nuk po lejojnë me marrë rrymën prej trafostacionit të fshatit Radeshë. Ne kemi qenë aty, e kemi mbajtur një takim me qytetarët e fshatit Radeshë dhe ju kemi shpjeguar se ky nuk është projekti jonë por projekti i KEDS-it, Komuna me shumë dëshirë kishte ranuar me marrë rrymën prej një lokacioni që është më afër, pastaj ne kemi bërë një kërkesë për me ndryshue lokacionin, KEDS-i nuk ka pranuar dhe ka thënë se duhet ju të punoni në bazë të lejës që kemi dhënë ne. Me banorët e Radeshës do ta gjejmë një zgjidhje tjetër, ndoshta do t'a marrim rrymën prej një trafostacionit tjetër që është që mundim më pak dëme t'i shkaktojmë infrastrukturës. Sa i përket numërit të punësuarve në Dragash, siç e dini numri i të punësuarve nuk është vetëm problem i imi por ka qenë edhe problemi i qeverisjeve të kaluara por megjithatë numri i të punësuarve me ardhjen time në pushtet në krahasim me të kaluarën është rritë por nuk është i kënaqshëm dhe i mjaftueshëm por ne në këtë mandat do të vazhdojmë të punojmë në këtë drejtim. Sa i përket komunitetit jo shumicë do t'i kemi politikat tona që numëri i të punësuarve të rritet gradualisht dhe vazhdimisht. Kemi pengesa, arsyeja është sepse ekziston mungesa e kuadrave dhe kemi qenë të detyruar shumë herë të anulojmë konkurse për arsye se nuk kanë pasur persona me kualifikime adekuate. Sa i përket ujit të pijshëm dhe ujësjellësit kryesor, pyetja se pse disa fshatëra paguajnë e disa jo ujë? Siç e dini qeverija e kaluar ka bërë një marrveshje me Hidroregjionin dhe ja ka qitë në pronësi rrjetin dhe rezervuarin Hidroregjionit. Këtu bëhet fjala për Dragashin, Pllavën, Breznen dhe një pjesë të Shajnës, kështu që, ne ujin j'au kemi qar këtyre fshatërave mirëpo ne nuk kemi kompetenca që ta ndalojmë që Hidroregjioni, qytetarëve të fshatit Brezne të ju bëjë pagesën. Edhe pse fshati Brezne ka qenë fshati i cili është ma i rrezikuar sa i përket ujit të pishëm, ata tash kanë ujë të mjaftueshëm, ka qenë edhe një delegacion para tri-katër ditëve tek unë dhe e kanë parashtruar këtë pyetje. Ata janë shumë të kënaqur sepse kanë ujë të mjaftueshëm. Mirëpo, ata janë të shqetësuar se pse po j'au bëjmë pagesën. Pagesën e bëjmë për arsye se qytetarët e fshatit Brezne dhe Hidroregjioni kanë kontrat që ata për shpënzimin e ujit të bëjnë pagesën dhe gjithashtu

prishjet që bëhen në sistemin e ujësjellësit në fshat ta rregulloj Hidroregjioni. Unë ju kam sygjëruar atyre që ta thërrasin kryeshefin e hidroregjionit në Prizren, në një takim ku do të jenë banorët dhe unë dhe ta gjejmë një zgjidhje. Që do të thotë, së paku ta ulim koston e shpenzimeve të pagesës. Arsyeja është se ata më nuk shpenzojnë rrymë, por e marrin ujin e gatshëm nga fabrika. Tash a do të gjendet një zgjidhje ngelet për t'u parë, ndërsa fshatrat tjerë të cilët furnizohen me ujë nuk paguajnë, sepse nuk janë të kyçur në sistemin e Hidroregjionit. Pasi që, hidroregjioni menaxhohet nga Qeveria e Kosovës, nga Bordi dhe Bordin e zgjedhë Parlamenti i Kosovës. Ndërsa ne kemi kompetenca të limituara sa i përket Ekoregjionit, ku një përfaqësues i komunës tonë është pjesë e bordit të Ekoregjionit. Kurse sa i përket Hidroregjionit, ne nuk kemi kompetenca.

Sa i përket ujësjellësit të Dragashit, ne do të punojmë që t'ju sigurojmë qytetarëve të Dragashit ujin e pijshëm dhe cilësor dhe të shëndetshëm përmes fabrikës së re dhe shpresoj që së shpejti do të dalim në terren dhe do të përgatitim projektin. Është e vërtetë që në Dragash nuk kemi investuar shumë, por kemi investuar në infrastrukturë, në ndërtesa, në shëndetësi, në arsim, edhe në rrugë, në kubëzime. Fillojmë renovimin e këtyre pesë-gjashtë ndërtesave, por sa i përket ndërrimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, ne kemi filluar me përgatitjen e një plani zhvillimor komunal dhe në kuadër të atij plani ne kemi paraparë ekspertë nga Hidroregjioni, Ekoregjioni dhe nga ministria, kështu që ne së pari duhet të bëjmë projektin për ujësjellësin e ri dhe kanalizimin, e pastaj do të ndajmë mjetet për këtë qëllim. Sa i përket pyetjes, sa stadiumit, të fshatit Pllavë, punimet nuk kanë filluar. Arsyeja është se terreni është ende i lagur dhe kur të përmirësohet koha, do të fillojnë punimet në këtë projekt. Sa i përket z.Afrora, ajo vetëm dha propozime, ndërsa sa i përket qenve endacak, nuk është vetëm problem i Dragashit, por është problem kombëtar dhe arsyeja është ligji. Është një ligj i Bashkimit Evropian ku qent i trajtojnë ashtu sikurse njerëzit, sepse ligji thotë: se qenin duhet me e zënë, me e trajtue, mjekue dhe kastrue dhe me e lëshue në vendin ku e ke marrë. Qëllimi i këtyre ligji është me e ndaluar shumimin e qenve endacak. Por këtu është problemi sepse po na i sjellin nga viset tjera me vutura këtu. Më herët ka qenë tjetër ligj ku ne i kemi eliminuar dhe groposur, mirëpo tash është tjetër ligj dhe nuk kemi të drejtë të bëjmë eliminimin e tyre. Kemi rënë në kontakt me një shoqatë turke, ku duam të ndërtojmë një strehimore të qenëve dhe i kemi shiquar tri lokacione dhe pastaj ata qentë endacak do të sistemohen aty. Sa i përket ambulantës në Restelicë, sipas ligjit, Restelicës i takon ambulanta shëndetësore. Në bazë të master planit për shëndetësi, mirëpo ne në këtë drejtim në bashkëpunim me drejtorin e QKMF-së dhe drejtorin e shëndetësisë, në bashkëpunim me subjektet e komunitetit jo-shumic do të

diskutojmë për këtë çështje. Ka mundësi të ja ndërrojmë lokacionin e ambulantës në Restelicë dhe Po, sa të caktojmë lokacionin në Restelicë, sigurisht do të ndajmë edhe mjete për ndërtimin e një objekti të ri. Gjithashtu, sa i përket kuadrit, mund të punësojmë edhe një mjek aty. Por problemi është se duhet ta gjejmë mjekun. Mjeku duhet të jetë nga komuniteti jo-shumicë. Në momentin që ju e gjeni mjekun, ne do ta shpallim konkursin edhe për një teknik medicinal pa problem. Ju faleminderit.

Grani Rifaj: Mbete pa përgjigje nga ana e kryetarit për rrugën e Kosavës së bashku me kanalizim dhe si ka qenë e paraparë. Tek stadiumi i Pllavës dhe i Blaçit, kryetari tregoi se nuk kanë filluar punimet, për arsye të lagështisë etj..., por në raportin financiar kanë qenë 50.000 dhe 70.000 euro të investuara. Domethënë, çka është kryer punë për atë shumë? Të trija këto projekte është mirë me na dhënë një përgjegjëje jo vetëm për mua, por për qytetarët. E kam edhe një pyetje për fshatin Brrut, rruga Likeni deri tek Lapidari, qytetarët thojnë që ka mbetur në gjysmë. A mundet të përfundoj kjo rrugë? Tek çështja e ujit, kryetari e shpjegoi se disa fshatra po e paguajnë ujin e disa jo. Unë jam për pagesë të ujit, mirëpo dikush ta paguaj e dikush jo, nuk është në regull. Shpresojmë se do të gjendet një zgjidhje pasi që është investim me taksa të qytetarëve. E kam edhe një lutje për kryetarin. Në rrugën e vjetër të fshatit Belobrad për në mejdan është bërë një deponi ilegale. Në qoftë se ka mundësi të ndërmarrë diçka kryetari.

Usmen Baldzi: Vetëm shkurt, për të ndihmuar kryesuesin. Neni 8 i Rregullores për punën e Zyrës për Komunitete thotë: Shefi i zyrës raporton rregullisht te kryetari i komunës; pika 2: Shefi i zyrës i dorëzon kryetarit të komunës dhe Kuvendit raportin vjetor të punës; dhe pika 3: Shefi i zyrës raporton në çdo takim të Komitetit për Komunitete — në çdo takim. Ndërsa fakti që privatisht ndoshta nuk duam të shikojmë njëri-tjetrin në sy është çështje tjetër, siç është edhe pjesë e mandatit. Për hir të së vërtetës, zoti kryesues, unë jua kam dërguar këtë rregullore. Lexojeni, dhe pastaj kërkojmë të njëjtën gjë. Dhe mos mendoni se dikush duhet të mburret nëpër korridoret e komunës sikur ai di e ne nuk dimë. Ju keni obligim që në Kuvend të na paraqisni raportin e punës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Artan Loshaj: Keni thënë që po bëhet fabrika e re dhe do t'a fusim në sistemin e ri qytezën, por rrjeti është i vjetër. Projekti është gati por vetëm duhet vullneti sepse i kam pyetur janë vetëm tre gypa, është 1.5 km, vetëm me pas vullnetin me e fut në buxhet të vitit 2027, dhe një pyetje j'au bërë të gjithëve se a keni pirë ujë të Dragashit? Askush nuk më është përgjigjur! Kolegë, shi kur të bjerë as delet nuk e pinë këtë ujë. Kryetari tha që projekti është bërë paushall për projektin e

ujës-jellësit, pse ju e keni marrë atë projekt dhe me atë projekt keni filluar investimet. Sepse unë e di që ky projekt ka qenë i PDK-së dhe kur keni ardhur në pushtet nuk e keni shiquar ku kemi bërë gabime, pse edhe ju e vazhduat po të njëjtin? Atë ditë ju kam takuar kur keni shkuar për në fshatin Radeshë dhe publikisht po ju them se në qoftë se nuk mund të bëni zgjidhje, unë po ju ofroj zgjidhje për fshatin Radeshë. Në qoftë të se ky projekti nuk bëhet, pasi që keni thënë se është duke punuar me dy gjenerator, atëherë çfarë zgjidhje kemi? Në qoftë të se nuk kemi zgjidhje me KEDS-in dhe me qytetarët e fshatit Radeshë, atëherë çfarë zgjidhje kemi? A ka mundësi me na tregue se çka do të bëhet, ndonjë zgjidhje konkrete? Sepse shumë para janë shpenzuar për këtë projekt. Tjetëra, mos ta keqpërdorën për qytetarët e Dragashit, fshatit Plavë, Brezne dhe një pjesë e Shajnës që paguajnë, ndërsa ajo pjesë tjetër nuk paguajnë, nuk jam kundër, është mirë, por unë e kam një pyetje: Pse nuk e bësh pagesën për të gjithë derisa nuk bëhet një zgjidhje? Pse nuk bëhet sikurse e keni bërë me mbeturinat? Bëje një gjashtëmujor dhe paguaje Breznës, Dragashit Pllavës dhe një pjese të Shajnës, paguaje ujin derisa të bëhet një zgjidhje. Unë nuk jam kundër pagesës, por standarde të dyfishta jo! Unë po bëj një kërkesë që me gjetë një zgjidhje për të gjithë qytetarët në afat prej gjashtë muaj ditëve.

Danis Hodza: Përsëritet të gjithëve. Së pari dua ta falënderoj Kryetarin e Komunës për mirëkuptimin. Sa i përket lokacionit, ne në Restelicë tashmë kemi një lokacion për ambulancën. Gjithashtu kemi edhe të rinj që kanë përfunduar shkollat e mjekësisë, dhe në këtë mënyrë do të mund të hapim konkurse dhe t'i punësojmë këta të rinj. Faleminderit paraprakisht.

Uzair Hamza: Përsëritet të gjithë asamblistëve. E di që pika “të ndryshme” ndonjëherë duket sikur është dytësore ose e mërzitshme, por kam obligim të përgjigjem në pyetjen që është përmendur, për të cilën kryetari nuk ka dhënë përgjigje, dhe që ka të bëjë me atë se kujt i janë ndërtuar shtëpitë. Mendoj se ata që e kanë ndjekur me vëmendje seancën e parafundit e kujtojnë se, gjatë miratimit të strategjisë për readmision, është ngritur një pyetje që nuk lidhej drejtpërdrejt me kthimin, dhe atëherë kam dhënë tashmë përgjigje se kujt i janë ndërtuar shtëpitë. Ekziston një bazë të dhënash, dhe Zyra është e obliguar të veprojë në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Të gjitha të dhënat që gjenden në atë bazë i përkasin vetëm përdorimit institucional dhe nuk mund të publikohen. Kur ne ndërtojmë një shtëpi për dikë, atëherë ajo edhe publikohet dhe dihet qartë se kujt i është ndërtuar shtëpia. Kush nuk beson, mund ta shikojë dokumentin që kemi nënshkruar, i cili na obligon sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave publike.

Sa i përket aftësive të mia, më vjen keq nëse dikujt i pengon kjo, ashtu si edhe fakti që nga viti 2013, para ardhjes sime në krye të Zyrës, nuk është ndërtuar asnjë shtëpi. Megjithatë, në vitin 2024, kur kam marrë funksionin e shefit të Zyrës, kam arritur të inicioj dhe realizoj ndërtimin e pesë, përkatësisht gjashtë shtëpive në Dragash. Në vend që kjo të njihet si rezultat dhe kontribut, dikush e interpreton ndryshe. Madje dikush ka thënë se jam “Messi” – dhe për këtë e falënderoj si kompliment. Unë gjithsesi jam krenar që kam mundur të jap kontribut, jo vetëm përmes investimeve kapitale, por edhe përmes sjelljes së projekteve të ndryshme që realizohen nga donatorë ndërkombëtarë, dhe dëshmitar i kësaj është edhe kryetari. Saktësisht edhe në Krstac dhe në fshatra të tjera, nga burime dhe projekte të ndryshme, prandaj mund të them vetëm se në periudhën e ardhshme presim të ndërtohen edhe dhjetë shtëpi. Sa i përket projektit të ndërtimit të shtëpive në kuadër të banimit social, dua vetëm të sqaroj këtë: unë jam anëtar i komisionit, dhe këtu është i pranishëm kryesuesi i cili mund të ma marrë fjalën, por jo ju, zotëri. Pra, bëhet fjalë për një projekt që vjen nga ministria kompetente, në kuadër të programit të banimit social dhe përmirësimit të efikasitetit energjetik të objekteve banesore. Udhëheqësi i këtij projekti është z. Burim Qafleshi. Faleminderit.

Shukri Myrtezani: Po ndërlidhëm me kolegun Artan. Herët ia ka nisur me bërë politikë. I tha kryetarit se po shkon dhe po kërkon vota në Breznë? Por kryetari është kampion që t’ia zgjidhësh dikujt problemin e jetesës, t’ia zgjidhësh problemin kryesor, domethënë t’ia dërgosh në shtëpi ujin, mendoj se është gjëja më e madhe të cilën e ka bërë kryetari. Kështu që është shumë ballëhapur dhe syçelë që të shkosh të kërkojë votën në ato pesëmbëdhjetë fshatra ku secili e ka ujin e pijshëm. Për shembull, ne si fshat, fshati i Zaplluxhës, nuk e kemi pasur atë ndjenjë kurrë. Në shumë fshatra ku nuk kanë ujë, atëherë më besoni se ja di vlerën ujit. Kështu që herët ia ke nisur të bësh politikë. Besoj që kryetari gëzon shumë autoritet për këtë çështje dhe nuk diskutohet për votë. Ju faleminderit.

Artan Loshaj: Kryetari shumë mirë ka bërë për ujin, por unë e di që krejt fshatrat nuk kanë marrë ujë. Kjo ka qenë një marketing politik parazgjedhor, sepse ujë kanë vetëm Brruti, Zgatarë dhe një pjesë e fshatrave. Për z.Uzair, ne e dimë se si i ka ndërtuar ato shtëpi dhe e dimë... kur është koha e fushatave, sepse i ka bërë mirë, mirëpo ai person të cilit ja ka ndërtuar është pa rrymë dhe ai e dinë shumë mirë. Mua më vjen mirë që e kanë ndihmuar, por së paku duhet të përfundojë deri në fund, d.m.th, atij personit të cilit ja ka ndërtuar shtëpinë është duke jetuar në shtëpi të vjetër.

Granit Rifaj: E kisha lutur kryetarin me qëndrue dhe me na dhënë përgjigje sepse jam kandidat për deputet dhe këtë e kam vërtetuar, por nuk ka lidhje, pasi që kryetari kërkoj edhe me shkrim se mos po i harroj. Ju faleminderit.

Resul Fetahu: Faleminderit! A do diksuh tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e mbyllim këtë seancë! Shihemi në seancat e tjera! Faleminderit!